



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

PROJEKTVENDIM

Nr. _____, datë ____ . ____ .2023

**“MBI PËRCAKTIMIN E TARIFËS PËR TË DREJTËN E KALIMIT
PER RRJETET E KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE TË
RREGULLAVE PËR MËNYRËN DHE AFATIN E PAGIMIT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3, të nenit 35, të Ligjit Nr. 120/2016 “Për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë dhe sigurimin e së drejtës së kalimit”, Këshilli i Ministrave me bashkëpropozimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë dhe të Ministrit për Infrastrukturën dhe Energjinë,

V E N D O S I:

1. Përcaktimin e tarifës për të drejtën e kalimit për ndërtimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike si dhe përcaktimin e rregullave për mënyrën dhe afatin e pagimit.
2. Tarifa e së drejtës së kalimit për shtrimin e tubacioneve, kablove për rrjetet e komunikimeve elektronike në autostrada, rrugë interurbane, dhe lokale, llogaritet sipas pikës I, të Shtojcës 1 dhe tarifa për vendosje të pajisjeve dhe përdorim të pronës publike, llogaritet për njësi të sipërfaqes sipas pikes II, të Shtojcës 1, bashkëlidhur këtij vendimi.
3. Tarifa për të drejtën e kalimit paguhet nga sipërmarrësit e rrjeteve të komunikimeve elektronike në bazë vjetore ose “one fee” dhe sipas kategorive të pronës publike ku do të kryhen punimet.
4. Tarifa vetëm për vitin e parë të fitimit të së drejtës së kalimit do të jetë proporcionale me kohën e marrjes së lejes dhe do paguhet për periudhën e mbetur të vitit.

5. Me qëllim arritjen e objektivave të “Planit Kombëtar për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Infrastrukturës Digjitale Broadband 2021-2025” :
 - a. Në zonat ku mungon infrastruktura e rrjetit të komunikimeve elektronike me shpejtësi të lartë, e drejta e kalimit për sipërmarrësit, të cilët duan të ndërtojnë rrjet të komunikimeve elektronike në pronën publike, do të ofrohet pa pagesë për tre vitet e para të ushtrimit të kësaj të drejte.
 - b. Në zonat me penetrim të broadbandit fiks, për familje me më pak mesatarja evropiane, e drejta e kalimit për sipërmarrësit, të cilët duan të ndërtojnë rrjet të komunikimeve elektronike në pronën publike, do të ofrohet pa pagesë.
 - c. AKEP përditëson çdo vit të dhënat për penetrimin e broadbandit fiks sipas bashkive dhe të mesatares evropiane.
6. Tarifa vjetore për të drejtën e kalimit paguhet nga sipërmarrësi i rrjeteve të komunikimeve elektronike tek autoriteti përgjegjës për dhënien e së drejtës të kalimit ,brenda muajit mars të çdo viti.
7. Ngarkohen organet e qeverisjes qendrore dhe vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren Zyrtare”.

KRYEMINISTRI

EDI RAMA

Tarifat për të drejtën e kalimit

- I. Tarifa e të drejtës së kalimit që lidhet me zënien apo përdorimin e hapësirës së rrugës, me qëllim instalimin e tubave, elementëve të infrastrukturës pasive të rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë në rrugët shtetërore, vendoset nga enti pronar i rrugës jo më e lartë se 10% e investimit përkatës nga subjekti kërkues për shtrirjen e këtij rrjeti. Kjo tarifë është “one fee”.
- II. Tarifa për përdorimin/zënien e hapësirës publike me qëllim instalimin e elementëve të infrastrukturës pasive të rrjeteve të komunikimit elektronike të shpejtësisë së lartë janë si më poshtë.

Mjedisi i aksesit	Tarifa mujore minimale për m ² hapësirë
Bashki-qytet Zona I	120 lekë/m ²
Bashki-qytet Zona II	90 lekë/m ²
Bashki-qytet Zona III	60 lekë/m ²

Shënim: Për njësitë administrative në bashkitë jo qendër rrethi, niveli tregues i tarifës për çdo zonë të treguar në tabelë është sa një e dyta e nivelit tregues përkatës.
Tabela e mësipërme është subjekt i rishikimit me ndryshimet në legjislacionin për taksat dhe tarifat vendore.